



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 28/18
Prishtinë, më 4.07.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontiq, Fikrim Damka dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Besnik Osmani - Auditor i Përgjithshëm, Adem Sylejmani nga ZKA, Valbon Bytyqi nga ZKA, Faruk Rrahmani nga ZKA, Raif Preteni, Drejtor i ARRU-së, Ramiz Krasniqi nga ARRU, Arsim Rashitaj – Kryesues i Komisionit Shqyrtues në ARRU, Florije Kika, zv.drejtor i AKKVP, Arben Ibrahimaj nga AKKVP, Ismet Kransiqi, Sekretar i Kuvendit, Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit.

Pjesëmarrës tjerë: Mentor Hyseni nga GIZ, Besjana Bajrami - gazetare, Nora Kokaj nga Ambasada Britanike, Egzon Dobroshi nga KDI, Albana Hajdari – Gazetare, Rabije Hyseni – Praktikante në Kuvend, Sahadete Zogaj – Gazetare, Bardhë Shkreli – Gazetare.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 06 dhe 20 Qershor 2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme dhe amendamenteve e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe amendamenteve e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe amendamenteve e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
9. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendi të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017;
11. Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017;
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2017;
13. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2018;
14. Shqyrtimi i Kërkesës nr. 06-P-064, dt. 26.06.2018 të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim na ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për miratimin e buxhetit të tij;
15. Shqyrtimi i Propozimit për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit për Ndhimë Shtetërore;
16. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona;
17. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozojë që në mungesë të Kryetares së KQZ-së, pika 10 e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht, me ndryshime. Pika 10 e rendit të ditës, shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 6 dhe 20 Qershor 2018

Kryetari – Konstatoi se komisioni unanimisht, miratoi procesverbalet e mbledhjeve të komisionit, dt. 6 dhe 20 qershor 2018.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kyetari: Theksoi se në bazë të deklaratës financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kyetari: Theksoi se në bazë të deklaratës financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kyetari: Theksoi se në bazë të deklaratës financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme dhe amendamenteve e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kyetari: Theksoi se në bazë të deklaratës financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe amendamenteve e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kyetari: Theksoi se në bazë të deklaratës financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe amendamenteve e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kyetari: Theksoi se në bazë të deklaratës financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projekt-Rregullore së Kuvendi të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Në draft rregulloren e propozuar janë edhe disa ndryshime lidhur me procedurën dhe afatet për shqyrtimin e buxhetit të Kosovës. Ndryshim tjetër është edhe tek hartimi i amendamenteve të propozuara nga deputetët dhe subjektet tjera në buxhetin e Kosovës, ku është përcaktuar se amendamentet nuk shqyrtohen nga komisioni, nëse nuk tregohet se ku duhet të mirren fondet. Një çështje diskutabile për komisionin është çështja e procedimit të amendamenteve për buxhetin pa përkrahen e komisionit në seancë plenare. Në bazë të praktikës në disa parlamente, prezantohen vetëm amendamentet që e kanë përkrahjen e komisionit.

Naser Osmani: Do të ishte me interes të diskutohet çështja e amendamenteve për buxhetin që nuk e kanë përkrahjen e komisionit, pasi që po bëhen kërkesa buxhetore për projekte që kanë kosto të lartë buxhetore dhe një amendament i tillë pa përkrahjen e komisionit po krijon probleme në Kuvend.

Kryetari: Nëse nuk ka ndonjë propozim dhe pasi që rregullorja nuk përmban implikime buxhetore shtesë, propozojë ta mbështesim dhe të procedojmë më tutje.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projekt-Rregullorja e Kuvendi të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbanë implikime buxhetore shtesë.

11. Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit (tutje ZKA) për vitin 2017

Kryetari: Kërkojë nga auditori të prezantojë raportin financiar dhe pastaj është mundësia për diskutime.

Besnik Osmani (tutje Auditori i Përgjithshëm): Theksoi se ZKA auditohet nga një kompani private e auditimit. U kam bërë kërkesën në Kuvendin e Kosovës për auditim dhe nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike kam marrë përgjigje që ne ta kontraktojmë një kompani të auditimit e çertifikuar ndërkombëtarisht e kjo është Grant Thorton që e ka kryer auditimit të cilin raport e kemi dërguar në Kuvend. Në vitin 2017 i kemi bërë 124 raporte të auditimit dhe natyrisht që këto tërheqin edhe kosto financiare dhe përkundër kësaj, niveli i shpenzimeve të buxhetit tonë është 95.4%. Nëse i marrim këto krahasime mes dy buxheteve ne kemi realizuar kursime për 19%.

Sa i përket raportit të auditorit që ka audituar institucion tonë është pozitiv apo opinion i pamodifikuar. Megjithatë, ne kemi marrë një letër prej menaxhmentit në të cilën janë dhënë disa vërejtje administrative të cilat do të adresohen nga ne. Sipas kategorive ekonomike, buxheti në paga dhe mëditje është 99.4%, mallra dhe shërbime 73%, shërbime komunale 71%, 94% investime kapitale që ka të bëjë me një sotwer që përdoret për qëllim të auditimit në vlerë prej 34,000 euro. Shpenzimet më të larta janë ato për mallrat dhe shërbimet që marrin pjesë me 32% e buxhetit, kjo edhe për shkak të qirasë së objektit, ndërsa shpenzimet e përditshme brenda dhe jashtë vendit janë 4% dhe 15% e shpenzimeve janë që lidhen me mirëmbajtje edhe paisjeve të IT-së.

Kryetari: Shpenzimet për qira janë 155,000 euro në vit, që është një shumë mjaftë e lartë që është një çështje problematike edhe me institucionet tjera dhe dikun rreth 8 milion euro nga buxheti i Kosovës

shpenzohen për qira. Për këtë çështje i kemi dërguar një letër Komunës së Prishtinës për gjetjen e një objekti për vendosjen e ZKA-së. Te pjesa financiare nuk kam komente tjera. Por te pjesa e punës më ka interesuar bashkëpunim me institucionet tjera? Specifikisht më intereson relacioni i auditorit të përgjithshëm me prokurorinë e Kosovës, çfarë ndodhë me të gjeturat në raportet tuaja në institucionet publike, si trajtohen më tutje?

Auditori i Përgjithshëm: Sa i përket bashkëpunimit me institucionet tjera është korrekt. Në kuadër të kompetencave tona që për nga natyra mund të klasifikohen si vepra penale ne e bëjmë një informacion për prokurorinë e shtetit dhe pastaj nuk përzihemi në kompetencat e tyre, por mbesim në bashkëpunim të prokurorisë që të ofrojmë të gjitha informatat të cilat i kemi në dispozicion dhe në bazë të së cilave është ndërtuar raporti i auditimit të një institucioni përkatës. Sa i përket objektit deri sa të vendosim në një objekt shtetëror jemi të detyruar me pagu qiranë.

Ali Lajçi: Kur kemi shqyrtuar raportin financiar të ZKA-së 2016, kemi kërkuar një listë prej qeverisë për objektet shtetërore të cilat nuk po shfrytëzohen dhe nuk po vendosen institucionet, pasi që shuma prej 8 milion euro për qira është një kosto e lartë dhe po të bëhej zgjidhja apo vendosja në objekte shtetërore, këto mjete do të mund të shfrytëzohen për diçka tjetër.

Blerim Kuqi: Theksoi se në bazë të raporteve të auditimit të përgaditur nga ZKA, e kemi vërejtur se në disa institucione, disa nga rekomandimet e auditimit po përsëriten prej vitit në vit. A ka mundësi ju si Zyrë me i trajtue këto rekomandime në formë më të veçantë?

Auditori i Përgjithshëm: Ne bëjmë dy lloje të raporteve dhe atë në dy nivele. Njëra është për institucionet individuale që i jepen rekomandimet atij institucioni dhe përmirësimet duhet të bëhen nga institucioni. Si dhe niveli i dytë është auditimi i pasqyrave financiare apo i raportit të qeverisë. Si përgjigje ndaj kësaj në dy vitet e fundit dhe për herë të parë nga Qeveria është bërë plani i veprimit i për zbatimin e rekomandimeve dhe janë shpërndarë detyrat në resoret e caktuara në ministri, por ato më shumë lidhen me ministrisën e financave për shkak të natyrës financiare. Mirëpo, fatëkeqësisht nuk kemi një proces që qeveria e ka vendosur të monitorimit të shkallës së zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe nuk ekziston një afat kohor se kur duhet të zbatohen këto rekomandime. Nga pikëpamja jonë nuk kemi autoritete ligjore që ti detyrojmë organizatat ti zbatojnë rekomandimet tona dhe e jona është që ti identifikojmë e ti sjellim raportet në Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendi të vë në llogaridhënie organet ekzekutive për raportim lidhur me përmbushjen e këtyre rekomandimeve. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve në nivelin lokal është 31%, në nivel të qeverisë është 34 % dhe tek institucionet e pavarura 40%.

Blerim Kuqi: Mendojë që është në interes që Auditori me shikue për së afërmi për moszbatimin e rekomandimeve nga vitet paraprake si dhe ato që përsëriten disa herë. Kjo do të na kishte ndihmuar edhe ne si Kuvend me luajtur rolin tonë ndikues në këtë punë. A ka mundësi me u përgadi një raport i veçantë për këto rekomandime të cilat nuk janë zbatuara për një afat të caktuar dhe për disa vite nuk janë adresuar ato nga institucionet përkatëse.

Kryetari: Tek shpenzimet e mëditjeve dhe të udhëtimeve jashtë vendit, nga raportet që kemi marrë shumica e institucioneve i realizojnë 100%, që duket pak e çuditshme si mundet një institucion me i planifikue dhe me i shfrytëzue saktë apo 100% shpenzimet jashtë vendit? E dyta në disa raporte financiare, kemi hasur se disa i paraqesin si mëditje e disa tjera si shpenzime tjera. A keni një formulë të mostrese që shfrytëzoni për auditimin e tyre.

Auditori i Përgjithshëm: Sa i përket rekomandimeve ne kemi bërë një risi në këtë vit dhe kemi prezantuar raportet e zbatimit të rekomandimeve të vitit pararpak dhe tani në raportet tona janë

rekomandimet për dy vitet e kaluara dhe është paraqitur shkalla e zbatimit të tyre. Ne do ti shfrytëzojmë të gjitha mundësitë se sa mund të shtrihet kjo periudhë kohore, por është e vështirë e identifikueshme në mënyrë historike dhe rrezikojmë saktësinë tonë dhe ne duhet të raportojmë vetëm ato të cilat i kemi testu dhe jemi të bindur e kemi fakte që janë shumë të sakta. Në faqen tonë elektronike ku janë publikuar raportet individuale të audituara, do të bëhet edhe përditësimi i zbatimit të rekomandimeve. Sa i përket udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, unë si Auditor i Përgjithshëm dhe ZKA-ja kemi bërë një kërkesë qeverisë që me urgjencë me ndryshue udhëzimin administrativ për vizitat jashtë vendit dhe qeveria është përgjigjur shumë shpejtë dhe ka ndryshuar udhëzimin dhe duke i trajtuar si mëditje dhe jo si shpenzime të lidhen me udhëtimin dhe e dyta janë bërë përmirësimet e tarifave sipas shteteve të caktuara ku shkohet duke pasur parasysh shportën e konsumit në vendet përkatëse. Me rastin e auditimeve ne marrim mostrat e caktuara të shpenzimeve. Ajo që i karakterizon shumicën e këtyre organizatave ka shumë vonesa në mbylljen e këtyre.

Enver Hoti: A ka ndonjë ndërmarrje publike që nuk është bërë auditimi i përgjithshëm së paku në vitin e fundit, dhe nëse po, cilat janë ato?

Auditori i Përgjithshëm: Me ardhjen time ne kemi filluar me auditimin e ndërmarrjeve publike dhe në vitin e parë ne kemi audituar 6 ndërmarrje publike, ndërsa në këtë vit janë 9 ndërmarrje publike të audituara. Me ngritjen e kapaciteteve tona ne po e rrisim edhe intenzitetin e auditimit të këtyre ndërmarrjeve. Për Auditorin e Përgjithshëm, auditimi i ndërmarrjeve publike nuk është obligativ dhe në bazë të Kushtetutes dhe Ligjit është inkurajuese të bëhen auditimet e tilla. Ndërsa obligative janë organizatat buxhetore që financohen nga buxheti i shtetit. Në planin strategjik për tri vitete e ardhshme, fokusi i auditorit është auditimi i performancës së ndërmarrjeve publike.

Enver Hoti: Ju po thoni se nuk është obligativ për auditorin e përgjithshëm auditimi i ndërmarrjeve publike, ndërkaq në strukturën organizative e keni divizionin e performances së ndërmarrjeve publike. Nëse e keni pjesë të strukturës së punës, a keni informacion saktë se ndërmarrjeve publike nuk është bërë asnjëherë auditimi?

Auditori i Përgjithshëm: Theksoi se është Ligji për ndërmarrjet publike ku thuhet se ndërmarrjet publike do të auditohen nga kompanitë e licencuara të auditimit e që angazhohet nga vetë ajo ndërmarrje, nëse nuk e ka bërë auditori i përgjithshëm. Nuk e di cilat ndërmarrje publike nuk kanë bërë auditime, por e di dhe e theksova se cilat ndërmarrje janë auditu prej nesh.

Enver Hoti: Ju lutem a ka mundësi me na dërgue një regjistër me shkrim për me pa cila ndërmarrje publike i keni audituar dhe cilat nuk i keni audituar?

Auditori i Përgjithshëm: Listën e ndërmarrjeve të audituara e kam dërguar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, por edhe në këtë komision dhe do t'ua dërgojmë prap nëse është e nevojshme.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit (tutje ARRU) për vitin 2017

Kryetari: Kërkojë nga përfaqësuesit e ARRU-së të paraqesin raportin financiar për vitin 2017 dhe më pas ia kalojmë fjalën auditorit të përgjithshëm dhe do të jetë mundësia për diskutime e deputetëve.

Raif Preteni: Theksoi se buxheti fillestar i ARRU-së për vitin 2017 ka qenë 358,734 euro, ndërsa realizimi është 332,564 euro. Sipas kategorive ekonomike: për paga dhe mëditje 207,197 euro, mallra dhe shërbime 121,990 euro, shërbime komunale 33,077 euro. Jemi pajtuar me kërkesën e Ministrisë e Financave për shkurtrimin e buxhetit prej 10,538 euro. Në fund kemi pasur një suficit të buxhetit prej 12,505 euro në mallra dhe shërbime dhe kjo ndodhur për shkak të procedurave nga ana e AQF-së. Janë realizuar të hyra nga taskat e licencimit në 98% e planifikimit. Ne jemi të vendosur në objekt privat dhe pagesa e qirasë është 42,000 euro, dhe kemi bërë kërkesa të vazhdueshme për vendosje në objekt shtetëror por nuk kemi gjetur ende zgjidhje.

Valbon Bytyqi: ZKA ka audituar pasqyrat financiare të ARRU-së dhe ka dhënë një opinion të kualifikuar. E gjetuara ka të bëjë nënvlerësimin e buxhetit për paga dhe mëditje për 10,539 euro si pasojë e një gabimi në vlerën e përmendur. Tek opinioni i auditimit mbetet edhe çështjet e raportimit të të hyrave kapitale, përkatësisht mungesa e vlerësimit të pasurive. Në raport me vitin paraprak në këtë autoritet janë bërë përmirësimet e dukshme në pjesën e qeverisjes që përfshinë rreziqet e mundshme dhe proceset lidhur me raportimin e monitorimit të proceseve në përgjithësi. Gjithashtu përmirësime janë vërejtur edhe në raportimin e të hyrave dhe shpenzimeve të arktueshme.

Në vitin 2016 i kemi dhënë 8 rekomandime, prej tyre 5 janë zbatuar, dy janë në proces dhe një ka mbetur pa zbatuar. Autoriteti është pajtuar me këto rekomandime dhe presim të përgaditet një plan të veprimit për implementimin e tyre.

Kryetari: Tek shpenzimet e udhëtimeve zyrtare brenda vendit i keni pasur 14,000 euro dhe i keni shpenzuar 12,000 euro, çfarë kanë qenë këto shpenzime?

Raif Preteni: Theksoi se jemi pajtuar me raportin e ZKA-së dhe ARRU do ta dorëzojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Lidhur me udhëtimet brenda vendit janë pagesat që bëhen për këshillat e konsumatorëve që vendosin për ankesat e ndryshme dhe secila komunë e ka një këshillë të tillë që shqyrtojnë ankesat e konsumatorëve.

Kryetari: Pyeti pse nuk është paraqitur ndaras ky shpenzim për pagesën e këshillave të konsumatorëve?

Raif Preteni: Sqaroi se pas konsultimit me Ministrinë e Financave, na është rekomanduar me paraqitje në këtë formë, pasi që nuk ka kod të veçantë ekonomik në pasqyrat e raportimit financiar për këtë shpenzim.

Arbërie Nagavci: Lidhur me personelin e ARRU-së është evidentuar që në vitin 2017 ka qenë 21 të punësuar, ndërsa është shkruajtur se procedurat e rekrutimit për tri pozita kanë vazhduar edhe në vitin 2018, pse është prezantuar në këtë formë?

Raif Preteni: Sqaroi se prezantimi i personelit është bërë në atë formë për shkak tri pozitive: njëra ka të bëjë me vdekjen e një zyrtare-kryesuese/analiste, dhe dy pozitat tjera kanë të bëjnë me një inspektore për standarde e shërbimit që inspekton punën e kompanive në teren dhe një zyrtare për licenca, dhe këto pozita tashmë janë plotësuar në vitin 2018 dhe tani jemi 21 të punësuar siç kanë qenë të planifikuar në vitin 2017.

Kryetari: Kërkojë nga kryesuesi i komisionit shqyrtues të ARRU-së z. Arsim Rashitaj, të prezantojë kërkesën e tij.

Arsim Rashitaj: Theksoi se në viti 2016 është emëruar nga Kuvendi si kryesues i komisionit shqyrtues të ARRU-së për shqyrtimin e ankesave në nivel të Kosovës, që ka të bëjë me ujin dhe që nga ajo kohë unë nuk jam kam marrë asnjë kompenzim për punë.

Kryetari: Në bazë të Ligjit për Shërbimet e Ujit, kryesuesi i komisionit shqyrtues i emëruar nga Kuvendi, nuk ka mardhënie të rregullt të punës dhe kompesimi i tij bëhet sipas angazhimit dhe sipas nevojë. Pyetja që duhet të sqarohet nga përfaqësuesit e ARRU-së është se a është angazhuar kryesuesi deri më tani dhe nëse jo, pse? A nuk ka pranuar ndonjë ankesë Autoriteti?

Raif Preteni: Siç e ceku edhe kryetari në bazë të ligjit kryesuesi i komisionit shqyrtues nuk ka mardhënie të përhershme të punës. Në legjislaturën e kaluar ne kemi ngritur në komision për buxhet dhe financa këtë çështje dhe sugjerimet e komisionit kanë qenë që Autoriteti me caktue një formë të meditjes për kompensimin e kryesuesit siç e parasheh ligji. Mbi bazë të kësaj unë kam marrë një vendim për caktimin e meditjes për kompensimin e kryesuesit të komisionit shqyrtues në shumë prej 65 euro për anagazhim në punë. Z. Rashiti që nga emërimi nuk është angazhuar sepse nuk kemi pranuar ankesa. Dje kemi pranuar një ankesë.

Kryetari: Ligjit po thotë se kryesuesi nuk ka marrëdhënie të rregullt pune dhe nuk mund të marrë pagë bazë, por kompenzimi duhet të bëhet sipas angazhimit.

Arsim Rashiti: Unë po pres një përgjigje nga komisioni dhe nëse nuk ka ndonjë zgjidhje për kompesim për punë po e shqyrtojë ankesën që është paraqit në ARRU në mënyrë vullnetare dhe po jap dorëheqje.

Kryetari: Do të kërkojmë nga sekretari i Kuvendit informata sqaruese lidhur me atë se si paguhen përfaqësuesit e institucioneve tjera si pozita e juaj dhe pastaj do të trajtojmë këtë çështje përsëri në komision.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2017.
2. Komisioni kërkoj nga Administrata e Kuvendit një Opinion Ligjor lidhur me Kërkesën e për kompensimin e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të ARRU-së.

12. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona

Kryetari: Kërkojë sqarime për kërkesën e Agjencisë lidhur me kompensimin e anëtarëve të komisioneve përkatëse.

Florijs Kika: Në bazë të Ligjit për krahasim dhe verifikim të pronës, ekzistojne këto dy komisione. Komisioni për kërkesa pronësore përbëhet prej 5 anëtarëve, ku 2 anëtar janë të huaj që emërohen nga Bashkimi Evropian dhe 1 anëtar emërohen nga Kuvendi. Kurse komisioni tjetër për verifikim dhe

vendosje për prona përbëhet prej 5 anëtareve, ku 3 anëtar janë të huaj që emërohen nga BE edhe 2 anëtar nga Kuvendi. Agjencia për verifikim të pronës është transformuar nga Agjencia kosovare e pronës dhe si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur dy antarë vendor të komisionit për verifikim dhe vendosje për pronat nuk kanë ekzistuar, pasi që ky komision është themeluar rishtazi me ligjin e ri. Ndërsa, anëtari për kërkesat pronësore ka ekzistuar edhe më herët, dhe ka mbetur që të shqyrtojë ndonjë kërkesë e mbetur nga mandati i agjencisë.

Kryetari: Pyeti pse ka paqartësi në kompensimin e këtyre anëtarëve të komisioneve? A janë të angazhuar me orar të plotë apo me gjysëm orari?

Florije Kika: Sqaroi se anëtari për kërkesa pronësore përcaktohet me ligj dhe është i paraparë nënin i cili thotë se paguhet për sesione, por shuma e kompensimit për sesione është e nevojshme të dihet apo përcaktohet. Për dy anëtarët tjerë të komisionit për verifikim dhe vendosje të pronës, ligji nuk ka rregulluar çështjen e kompensimit të tyre. Meqë ata i ka emëruar Kuvendi në muajin mars të këtij viti, ne nuk kemi ditur ku të adresojmë çështjen e zgjidhjes së shumës së kompesimit të tyre, prandaj iu kemi adresuar Kuvendit. Në të kaluarën jemi financuar me donacione, ndërsa nga viti 2010 kemi kaluar si shërbyes civil dhe nga Ministria e Administratës Publike është përcaktuara rroga e komisionerit.

Mërgim Lushtaku: pyeti a është Agjencioni ne kuadër të Kuvendit apo ne kuadër të Qeverisë?

Florije Kika: Sqaroi se Agjencioni është në kuadër të Kuvendit.

Mërgim Lushtaku: Çështja është se janë bërë disa studime dhe analiza lidhur me disa agjencioni që veprojnë në kuadër të ekzekutivit dhe të Kuvendit dhe ky Agjencion do të ishte mirë me u trajtuar në kuadër të Qeverisë. Ndërsa, sa i përket shqyrtimit të kësaj kërkesë do të ishte mirë të krijonin një grup punues ku do të analizohet më detalisht kërkesa dhe të bëhen krahasimet me agjencitë tjera. Për këtë na duhet edhe një analizë e përgaditur nga Agjencia.

Kryetari: Unë mendoj se ne sot nuk mund të vendosim në mënyrë arbitrare për kompensimin e këtyre anëtarëve. Propozimi i z. Lushtaku është i qëlluar që të krijojmë një grup punues ku do të analizohen kërkesat dhe pastaj do ta shqyrtojmë sërish në komision. Propozojë që grupi punues të përbëhet nga: Mërgim Lushtaku (kryesues) dhe Arbërie Nagavci (anëtare). Grupi punues paraqet raportin me rekomandime në komision.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Caktohet Grupi Punues për shqyrtimin e Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona, në përbërje: Mërgim Lushtaku (kryesues) dhe Arbërie Nagavci (anëtare).
2. Kërkohej nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ti dërgojë Komisionit një analizë për natyrën dhe vëllimin e punës së anëtarëve të komisioneve për kërkesa pronësore dhe për verifikim dhe vendosje për prona.
3. Grupi Punues paraqet raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

13. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2018

Kryetari: Kërkojë nga Sekretari i Kuvendit prezantimin e raportit tremujor të shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018.

Ismet Krasniqi: Theksoi se administrata ka përgaditur raportin tremujor të shpenzimeve për vitin 2018 dhe në bazë të të dhënave në raport, për paga dhe mëditje buxheti është shpenzuar 100%, mallrat dhe shërbimet janë realizuar 39.6%, shpenzimet komunale janë realizuar 75.95%, subvencionet dhe transferet 70.32%, ndërsa shpenzimet kapitale 0%.

Kryetari: Janë disa çështje të shpenzimeve që kërkojë sqarime për të cilat i kam drejtuar Sekretarit edhe pyetjet me shkrim. Shuma e subvencioneve dhe transfereve është 25,000 euro, që duket mjaftë e lartë dhe më intereson se për çfarë janë shpenzuar këto mjete? Çështja e dytë ka të bëjë me udhëtimet zyrtare, ku sipas të dhënave në raport, deputetët janë shpenzuar 21,000 euro, ndërsa stafi i administratës 23,000 euro. Si është e mundur që administrata me shpenzu për mëditje jashtë vendit më shumë se sa deputetët? Do të ishte mirë që të reduktohen ekipet e mëdha dhe mos të duken vizitat jashtë vendit si ekskursionet. Pyetja e tretë e që këtu po flas në emër të LDK-së dhe jo si kryetar i komisionit dhe ka të bëjë me këshilltarët e kryetarit të Kuvendit: sa janë të angazhuar për këta tre muaj? Cila është paga e tyre? Sa janë shpenzimet e tyre të përfaqësimit, të drektave zyrtare dhe të udhëtimeve dhe mëditjeve jashtë vendit?

Naser Osmani: Nga raporti shifet se disa shpenzime të larta janë bërë në një apo dy restorante dhe janë nënshkruar faturat dhe njerzit aty shkojnë vetëm për qef. Por kjo është qështje që nuk mund të përgjigjet sekretari dhe duhet të diskutohet në Kuvend. Ndërkaq, fatura për shpenzimet në hotelin në Brod është e pakuptimtë?!

Ismet Krasniqi: Në pyetjen për subvencionet, për deputetin e ndjerë Kika janë ndarë si subvencion mbi 500 euro. Për një zyrtar të administratës me nevoja të veçanta është kompenzuar me 500 euro. Po ashtu kemi ndarë mjete një zyrtar i cili ka pasur nevojë për ndihmë financiar për djalin e tij. Ndërsa, kemi edhe një memorandum mirëkëptimi për pagesën e qirasë në shumë prej 5,725 euro të një organizate joqeveritare e ashtuquajtur Toka, për implementimin e një projekti që është miratuar nga Kuvendi. Shpenzimet tjera për subvencione kanë qenë për një projekt për një organizatë jo qeveritare Tika, që është i karakterit multietnik në shumë prej 4,000 euro. Një shumë prej 3,000 euro për një OJQ Ballkan Smile, që zbaton po ashtu një projekt multietnik. Të gjitha shpenzimet për subvencione dhe transfere janë ndarë me vendime të Kryesisë dhe mbështetur në Rregulloren për ndarjen e mjeteve për subvencione dhe transfere.

Sa i përket udhëtimeve zyrtare, kemi një situatë se shumë deputete ne raste udhëtojnë jashtë vendit me mbështetje të donatorëve e administrata shkon me shpenzime të Kuvendit. I kemi gjashtë organizata partnere të Kuvendit që bëjnë ftesa për deputetët dhe i mbulojnë shpenzimet, ndërsa deputetët kanë nevojë me i përcjellë me staf, edhe pse jo gjithmonë por 30% e stafit të administratës që përcjellin punën e deputetëve shkojnë me shpenzime të Kuvendit.

Tek numri i këshilltareve të kryetarit të Kuvendit, çështja e pagesës është e caktuar nga Kryesia në vitin 2011 dhe nuk kanë lëvizur pagat që nga ai vit, ndërsa numri ka lëvizur dhe këto janë të mbuluara me vendime të Kryesisë dhe me kontrata. Këshilltarë angazhojnë edhe grupet parlamentare dhe nënkrytarët e kryesisë dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen direkt nga puthëndhënsi dhe administrata nuk ka ndikim këtu. Të gjitha shpenzimet, përfshirë vizitat brenda dhe jashtë vendit janë të mbuluara me vendime përkatëse.

Kryetari: Pyeti sekretarin sa këshilltar i ka Kryetari i Kuvendit dhe sa është paga mesatare e tyre?

Ismet Krasniqi: Sqaroi se me vendine të Kryesisë janë me 14 këshilltarë dhe pagat e tyre variojnë në 1400 euro, 1070 euro dhe të tjerët 1040 euro.

Kryetari: Sa i përket drekave zyrtare te pjesa e anëtarëve të Kuvendit janë shpenzuar rreth 15,000 euro që i bjenë 250 euro në ditë për dreka. Si është mundur një institucion kaq i vogël me i hangër 250 euro në ditë dreka, që po më duket shumë shpërdorim i madhë.

Ismet Krasniqi: Sa i përket investimeve kapitale, tri lëndë që nga viti 2017 i kemi në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe për shkak të mungesës të anëtarëve nuk po arrinë me i shqyrtue lëndët. Kjo po ndikon edhe në performancën e shpenzimeve të buxhetit të Kuvendit, dhe këto procedurat teknike që lidhen me prokurimin po nxjerrin një performancë jo të mirë të shpenzimeve kapitale.

Enver Hoti: Investimet kapitale shifet se janë realizuar 0%, a është kjo si pasojë se nuk ka pasur ofertues të intresuar? Janë disa shpenzime si ato për shërbimet e arsimit, trajnimit dhe marketingut mbi 6,000 euro, mirëmbajta e objektit 9,000 euro, që në total janë mbi 187,000 euro më të mëdha se në vitin 2017.

Ismet Krasniqi: Tek tabela e krahasimit është një trajnim që është organizuar për zyrtarët që quhet E-prokurimi, që përfshin zyrtarët e prokurimit, menaxherët e kontratave dhe janë 13 veta që kanë ndjekur këtë trajnim. Po ashtu i kemi edhe shpenzimet për deputetët pasivë deri më 4 maj 2018.

Mërgim Lushtaku: Ajo që më intereson është çështja e digjitalizimit të administratës dhe zëvendësimit të përdorimit të letrës. Kjo për shkak të efikasiteti në punë, por edhe kursimit të shpenzimeve të letrës që janë mjaftë të mëdha.

Arbërie Nagavci: Edhe unë i shprehu shqetësimet e mija për shpenzimet për dreka dhe për subvencione. A mundemi me pas një raport më të detalizuar apo procesverbalet për ndarjen e subvencioneve që kanë ndodhur deri më tani?

Ismet Krasniqi: Sa i përket digjitalizimit është një projekt që është rifillu këtë vit. Ne kemi një buxhet të planifikuar për blerjen e llap topëve për deputetë në mënyrë që të heqim letrën dhe meqë paisja e IT-së ka kaluar në procedura të centralizuara të prokurimit, ky tender duhet të shpallet nga AQF. Në anën tjetër kemi mbi 40 deputetë që nuk i kanë hapur email-at zyrtare.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2018.

11. Shqyrtimi i Kërkesës nr. 06-P-064, dt. 26.06.2018 të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim na ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për miratimin e buxhetit të tij

Kryetari – Nga Kryesia e Kuvendit jemi ngarkuar që të shqyrtojmë kërkesën e Komisionit Hetimor për caktimin e buxhetit.

Mërgim Lushtaku: Do të ishte e rregullt të pritej fillimisht vendimi i Kuvendit për vazhdimin e mandatit të komisionit, që është në rend dite në seancën e radhës dhe pastaj të shqyrtojmë kërkesën për caktimin e buxhetit.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisionit unanimit, vendosi që kërkesa Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim na ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për miratimin e buxhetit të tij, të shtyhet për shqyrtim, pas vendimit të Kuvendit për vazhdimin e mandatit të këtij komisioni.

11. Shqyrtimi i Propozimit për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore

Kryetari: Në mbledhjen e kaluar e kemi diskutuar çështjen e caktimit të kompensimit apo pagës për anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, që do të zgjidhen nga Kuvendi dhe jemi pajtuar që si mesatare të marrim pagat e kryesuesve dhe anëtarëve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në bazë të kësaj mesatare, paga e kryesuesit është 1,145 euro bruto në muaj, ndërsa e anëtarëve 1,044 euro. Këto paga do të zbatohen nga momentin i emërimit të këtyre anëtarëve dhe deri në miratimin e ligjit për pagat.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisionit unanimit për Kuvendin, nxori këtë

Propozim – Vendim

Për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore

1. Kryesuesit të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, i caktohet paga në shumën prej 1,145 euro, bruto në muaj.
2. Anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, i caktohet paga në shumën prej 1,044 euro, bruto në muaj.
3. Niveli i pagës së kryesuesit të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, sipas pikës 1 të këtij Propozim-vendimi, bëhet nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, përmes mjeteve buxhetore të ndara nga Ministria e Financave si subvencione dhe transfere, dhe fillon të zbatohet nga data e emërimit të tij nga Komisioni për Ndihmë Shtetërore, e deri në miratimin e Ligjit përkatës për pagat.
4. Niveli i pagës së anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, sipas pikës 2 të këtij Propozim-vendimi, bëhet nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, përmes mjeteve buxhetore të ndara nga Ministria e Financave si subvencione dhe transfere, fillon të zbatohet nga data e emërimit të tyre nga Kuvendi i Kosovës, e deri në miratimin e Ligjit përkatës për pagat.
5. Selia e Komisionit për Ndihmë Shtetërore është në Ministrinë e Financave.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku